



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 2.4.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26.3.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbeturina,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor nga ZRRUM,
6. Shqyrtimi i dy Projektligjeve në parim, për ndërtim dhe për pasurimin e miellit,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.3.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26.3.2012, ndërkaq u miratua edhe shtesa e **Liburn Aliut** i cili kërkoi të plotësohet procesverbali i datës 22.3.2012 për Hoçën me komentet e tij për secilin amendament veç e veç.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbeturina

Kryetari Nait Hasani në vazhdim udhëhoqi votimin për secilin amendament veç e veç të cilat janë nxjerr në komision bashkërisht me ekspertin e emëruar. Në amendamentin 33 komisioni ndryshoi fjalën “duhet” me “obligohet” sa i përket paragrafit 5 të neni 54, ndërsa po në të njëjtin paragraf **Sevdije Lama** kërkoi të ndryshohet edhe fjala “mbeturinat” me fjalën “mbetjet” por komisioni nuk miratoi ngase si tha **kryetari** nëse e bënë këtë komisioni, atëherë duhet të sqarohet çka parasheh njëra dhe çka tjetra fjalë. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET raporti me rekomandime i grupit punues të udhëhequr nga Nait Hasani lidhur me Projektligjin për Mbeturina, dhe e njëjta përcjellët Kuvendit të Kosovës për miratim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e rrezatimeve dhe siguria bërthamore

Nait Hasani hapi diskutimin dhe sqaroi çështjet e mbetura lidhur me këtë Projektligj duke potencuar mbështetjen e zyrës amerikane për agjenci të veçantë lidhur me këtë ligj, ndërsa **Liburn Aliu** kundërshtoi formimin e agjencie pranë kryeministrit si dhe të kësaj agjencie për këtë ligj. Kompromisi i **Salih Morinës** ishte të ftohet Ministri i MMPH dhe të sqaroi përfundimisht si të mbetet kjo çështje, me MMPH apo në zyrën e kryeministrit të formohet agjencia në fjalë, deri në mbledhjen e radhës sot një javë.

5. Shqyrtimi në parim i dy Projektligjeve

Nait Hasani hapi diskutimin dhe japi sqarime për takimin për “Ndërtimet” në Gërmi dhe ftoi komisionin për të përcjellë më tutje në procedurën parlamentare, por **Liburn Aliu** kundërshtoi Projektligjin në fjalë ngase nuk trajton si duhet çështjen e licencimit dhe devijon shumë nga ligji në fuqi për ndërtime. Në Gërmi, vazhdoi, prezantimi ishte i njëanshëm ndaj duhet të epen mundësitë për sqarime palëve të interesuara. **Nait Hasani** dhe **Daut Haradinaj** theksuan se kuptojnë vërejtjet nga z. Aliu mirëpo rregullorja e Kuvendit sqaron qartë procedurën parlamentare, në këtë fazë ose duhet ti kthehet projekti propozuesit ose të procedohet më tutje. **Liburn Aliu** tha ndoshta është ndonjë vizion i mirë ky projektligj por paraprakisht duhet të vërtetohet se nuk janë shkelë procedurat e caktuara dhe nuk është injorua publiku, ngase si tha ai për satën herë MMPH po e sjell komisionin në pozitë të rëndë për shkak se tani duhet ti kryej punët që ajo nuk i ka kryer, megjithatë “ nëse duhet fjala e fundit atëherë jam për ta kthyer” përfundoi ai. **Nijazi Idrizi** sqaroi se është njoftuar me vërejtjet e shoqatës së arkitektëve dhe ishte i mendimit që ato vërejtje mund të përballohen me amendamente që do ti sugjeroj komisioni në vazhdim të procedimit të Projektligjit. **Nait Hasani** konstatoi se shumica sugjerojnë shqyrtimin edhe një herë në parim të këtij projektligji ngase nesër është takimi në MMPH pikërisht për këtë Projektligj, në orën 13,30. **Liburn Aliu** nuk kundërshtoi shqyrtimin edhe një herë të Projektit në parim por fuqishëm kundërshtoi se lidhur me këtë Projektligj ka “interesa personale të arkitektëve” ngase arkitekti duhet të filloj dhe të mbaroi kur është fjala për ndërtimin, kjo është rregull. Ai luti deputetët që të lexojnë çka është ndërtimi para se të paragjykojnë. **Daut Haradinaj** reagoi “edhe ti mos merr guximin me kthye diçka pa e ditur se si ka përgatitur dikush një projekt, por vetëm thuaje qëndrimin personal, ngase nuk mundesh mi thënë dikujt lexo apo diç të tillë”. Edhe për këtë pikë **Salih Morina** propozoi kompromisin që të shtyhet kjo pikë për mbledhjen e radhës, ngase shumë çështje do të sqarohen në takimin e nesër të organizuar nga MMPH. **Nait Hasani** konstatoi se për këtë Projektligj do të diskutohet edhe në mbledhjen e radhës, ndërsa rreth Projektligjit për pasurimin e miellit komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET në parim Projektligji për pasurimin e miellit dhe i rekomandohet mbledhjes plenare për miratim në parim.

6. Shqyrtimi i raportit njëvjeçarë nga ZRRUM

Nait Hasani përshëndeti **Raif Preteni** me bashkëpunëtorë dhe hapi diskutimin për raportin e dërguar në Kuvend për miratim. Z. Preteni falënderoi dhe sqaroi gojarisht çështjet që janë cekur në raportin me shkrim të dërguar fillimisht komisionit funksional dhe u fokusua në ndryshimet kryesisht pozitive që janë bërë në periudhën një vjeçare, sidomos në ndryshimet pozitive rreth arkëtimit (rritja nga 66% në 69%) etj. Kjo zyre gjithashtu, vazhdoi ai, ka amendamentuar dy rregulla me të cilat rregullohet çështja e ujëmatësve, instalimi i të cilave duhet të përfundojë deri më 28 qershor 2012, përveç në ato vendbanime (banesa shumë të vjetra kolektive) ku nuk është e mundur vendosja, ku faturohet sipas asaj sa anëtarë të familjes janë.

Në vazhdim disa anëtar të komisionit (**Liburn Aliu, Afërdita Berisha, Nait Hasani, Nijazi Idrizi dhe Sevdije Lama**) reagues në mënyrën jo aq korrekte të faturimit të ujit ngase p.sh. banesat që nuk kanë ujëmatës faturohen për 30 metra kub paushall pa marr parasysh a jetojnë aty, sa jetojnë aty etj. z. Preteni tha se pikërisht kjo është ndaluar me rregullore të re, ngase është dhënë afati deri kur çdo qytetar duhet të ketë ujëmatësin. Liburn Aliu shtoi se faturimi paushall që ka qenë 7 euro tani është bërë 15 euro, kërkoi sqarim pse kjo ka ndodhë, është fjala për ndonjë dënim apo çka. Zyrtarët nga ZRRUM sqaruan këtë se çdo qytetar duhet të vetëdijësohet dhe personalisht të angazhohet në këtë drejtim, p.sh. të reagoi me shkresë duke cekur kërkesën e caktuar (p.sh. me kërkesë tek kompania të sqaroi sa anëtarë janë, brenda një periudhe nuk do të jetë në banesë etj). Në vazhdim zyrtarët e ZRRUM sqaruan edhe për disa trende pozitive në këtë zyre por edhe për rritjen e ankesave tek qytetarët ngase popullata (sidomos në kryeqytet) rritet ndërsa standardet ende janë të pandryshuara.

Nait Hasani konstatoi se komisioni vlerëson se raporti nuk përmbush nevojat për të miratuar komisioni, ndaj u kërkua rishikimi dhe plotësimi dhe të dërgohet prapë në Komision kur do të shqyrtohet mundësia e miratimit në mbledhjen plenare.

7. Të ndryshme

Nait Hasani hapi diskutimin për çështje të ndryshme ndërsa **Liburn Aliu** kërkoi që komisioni çdo herë të diskutoi një javë përpara çështjet e rëndësishme në komision në mënyrë që mos të ndodhë që ndonjë anëtar i komisionit të mos njoftohet për ndonjë vizitë jashtë apo brenda, p.sh. ai personalisht ka pasur dëshirë të marr pjesë në takimin me KPMM por është njoftuar vonë (një ditë përpara dhe atë pasdite). Ai potencoi se nuk është arsye që ai është ngarkuar si anëtar në dy komisione parlamentare, ngase nëse diskutohen çështjet në komision, ka mundësi ti aranzhoi takimet.

Mbledhja përfundoi në orën 13,10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani